

# Solidariteti arma e popujve

Ndryshimet e kushteve sociale në Greqi, si edhe në të tërë botën janë të padiskutueshme. Nën justifikim e krizës ekonomike, bosat dhe pronarët ndërkombëtarë me ndihmën e qeverisë greke sulmojnë nga të gjitha anët ata që janë të tepërt në ingranazhin e makinerisë kapitaliste si edhe ata të cilët janë një pengesë për planet e tyre për zhvillim, qofshin vëndas ose emigrantë, të punësuar apo të papunë.

Mbështetja e ideve fashiste dhe konservatore nga shteti dhe policia, nga pronarët vendës dhe të huaj si edhe nga mas media kanë për qëllim, aplikimin rraprezal të operacionit KSENIOS ZEFS (i njëjti operacion si operacioni fshesa që ishte ndërmarrë vite më pare kundrejt emigrantëve Shqiptarë), krijimin e kampeve të përqëndrimit dhe izolimin afatgjatë të emigrantëve nëpër to si edhe torturat e njerëzve nëpër bodrumet e policisë. Me mbështetjen politike të partisë fashiste Agimi I Artë (Hrisi Avgji) tashmë e njohur zyrtarisht si edhe të policisë, janë armatosur duart e togave moderne të bastardëve fashistë si edhe të ithtarëve të tyre të cilët sulmojnë imigrantët nëpër zonat ku banojnë dhe punojnë për të sjellë ndërment ngjarjet e fundit në Manoladha të Peloponezitet.



Mbështetja e padiskutueshme dhe e vazhdueshme e ideve fashiste është e lidhur ngushtë me dilemat dhe kërcënimet friksuese të bankierëve, huadhënësve dhe qeverive, me varfërine dhe gjendjen e mbimjerueshme të cilat janë vazhimisht në rritje, me frikën dhe diskriminimin me të cilat përpiqen të shkaktojnë përçarje në rradhët e të varfërve. Ata kërkojnë që të jemi në vetmi e të pafuqishëm, të heshtur dhe të friksuar, të humbur dhe të përçarë nën dogmat e dallimeve raciale, etnike, fetare, gjinore e seksuale, për të vazhduar të na pijnë gjakun, të na shtypin dhe të na shfrytëzojnë për tu pasuruar me djersën tonë.

Nuk ekziston asnjë faktor që mund të përçajë të gjithë ata të ndodhen në shkallët e “poshtme” të kësaj bote.. Uniteti dhe solidariteti të bëhen armët tona kundër neototalitarizmit. Të ndërtojmë së bashku komunitetet e «luftës» nëpërmjet të cilave të luftojmë për të zhdukur padrejtësinë dhe shtypjen e njëriut nga njëri. Në këtë luftë armiku mbrohet dhe sulmon (me policë dhe fashistë), duke u përpjekur të mbys çdo reagim. E vetmja perspektivë që hapet për secilin prej nesh është ajo e «luftës». Një “luftë” konfrontuese, që është në gjendje të godasë dhe të zhdukë bastardët fashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre dhe që do të bëjë të mundur lindjen e një botë të lirë, me solidaritet dhe dinjitet.

## Le të bëhet “lufta” festa tonë

Të bashkuar vendas dhe emigrantë për një luftë sociale të organizuar  
Për të mbrojtur ambientet publike dhe sheshet nga fashistët  
Për të krijuar marrëdhënie solidariteti përtej kufijve dhe feve

**Iniciativa anarkiste / antiautoritare**  
**nga “rrëzët e malit Imitu”**  
paapty.squat.gr / paapty123@yahoo.gr

